



ODA EKONOMIKE E MAQEDONISË VERI-PERËNDIMORE
СТОПАНСКА КОМОРА НА СЕВЕРО-ЗАПАДНА МАКЕДОНИЈА
ECONOMIC CHAMBER OF NORTH-WEST MACEDONIA

KODEKS

I PRAKTIKAVE TË MIRA AFARISTE



oemvp.org

PËRMBAJTJA

<u>1. PJESA HYRËSE: DISPOZITA TË PËRGJITHSHME TË KODEKSIT</u>	4
<u>2. DEKLARATA PËR QËLLIMIN E KODEKSIT PËR PRAKTIKA TË MIRA AFARISTE</u>	5
<u>3. KORNIZA DHE PËRGJEGJËSIA JURIDIKE SI DHE ADMINISTRIMI I PUNËS SË SUBJEKTIT AFARIST</u>	6
<u>4. RAPORTI NDAJ KLIENIT / KONSUMATORIT DHE PALËT E TRETA / PARTNERËT E SUBJEKTIT AFARIST / BIZNESIT</u>	7
<u>SHITJA E PRODUKTEVE DHE OFRIMI I SHËRBIMEVE SIPAS STANDARDEVE MË TË MIRA DHE NDALIMI I KEQPËRDORIMIT DHE PRAKTIKAVE JO-FER TREGTARE</u>	8
<u>TRANSPARENCA, NDALIMI I KONKURENCËS JO LOJALE DHE PRAKTIKAVE TJERA NEGATIVE NË BIZNES</u>	9
<u>5. PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE E KOMPANIVE: POLITIKAT DHE AKTIVITETET PËR MBËSHTETJE TË SHOQËRISË DHE AMBIENTIT KU VEPRON KOMPANIA</u>	11
<u>6. TË DREJTAT THEMELORE DHE RAPORTET NDAJ EKIPIT, PUNËTORËVE DHE AKSIONARËVE</u>	12
<u>7. PUNA DHE FUNKSIONIMI AFARIST NË KUSHTE PANDEMIE (COVID-19) SI DHE RRETHANA TJERA TË JASHTËZAKONSHME</u>	13
<u>8. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE TË KODEKSIT</u>	15

PJESA HYRËSE

1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME TË KODEKSIT

Kodeksi i praktikave të mira afariste i OEMVP (këtu dhe në tekstin e mëposhtëm: Kodeksi) është dokument i cili buron drejtpërdrejtë nga Statuti i Odës ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore si dhe nga orientimi proaktiv i saj për të kontribuar në ngritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin të kushteve të veprimit në kuadër të subjekteve afariste – anëtarë të Odës ekonomike.

Kodeksi bazohet dhe zbatohet sipas disa parimeve dhe dispozitave të përgjithshme nga të cilat burojnë dhe dispozitat tjera specifike.

- **Besueshmëria dhe kredibiliteti;**
- **Respekti për individin dhe shoqërinë;**
- **Komunikim i transparent dhe i drejtë;**
- **Respektimi i dispozitave ligjore si dhe Statutit të OEMVP;**
- **Konkurrenca e drejtë, fer dhe lojale;**
- **Mbrojtja e informacionit dhe të dhënave personale;**
- **Parandalimi i konfliktit të interesit;**
- **Mbrojtja e shëndetit dhe siguria në punë;**
- **Transparenca, llogaridhënia dhe pjesëmarrja proaktive e gjithë akterëve të biznesit.**

DEKLARATA PËR QËLLIMIN E KODEKSIT PËR PRAKTIKA TË MIRA AFARISTE

- Qëllimi i këtij Kodeksi të praktikave të mira afariste është të kontribuojë drejt vendosjes dhe zhvillimit të vlerave dhe praktikave të mira të punës dhe funksionimit në kuadër të subjekteve afariste, anëtare të Odës ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, rrjedhimisht edhe ngritjes së kapaciteteve organizative të tyre.
- Qëllimet specifike të këtij Kodeksi janë krijimi i ambientit të shëndoshë në punë në nivel të subjektit afarist, në të gjitha sferat e veprimit, ndërtimi i raporteve korrekte të bashkëpunimit dhe kolegialitetit, respektimi i ligjeve e rregullave, etika dhe objektiviteti në kryerjen e detyrave të punës dhe të veprimtarisë afariste në tërësi.
- Ky Kodeks vlen dhe zbatohet për të gjithë, përfshirë punonjësit, bashkëpunëtorët, zyrtarët e subjektit afarist si dhe filialet e saj, anëtarët e organeve udhëheqëse dhe akterëve tjerë të cilët kryejnë punë dhe shërbime të caktuara për subjektin afarist.
- Kodeksi për më tepër do të ndihmojë menaxhmentin si dhe të punësuarit në subjektet afariste të ecin në hap me kohën dhe trendet bashkëkohore, sipas standardeve më të larta etike, përfshirë edhe sfidat e reja e posaçërisht funksionimin në kohë të krizës dhe pandemisë globale (Covid-19), në mënyrë që ata të veprojnë dhe të marrin vendime të cilat janë në përputhje me vizionin, misionin si dhe qëllimet e subjektit afarist.
- Është përgjegjësia e secilit pjesëmarrës në subjektin afarist, udhëheqës dhe të punësuarit, administratës, poashtu edhe partnerët e biznesit, që të përkujdesen për zbatimin e këtij Kodeksi dhe parimeve gjatë punës së përditshme, si dhe të njëjtin ta promovojnë edhe ndaj subjekteve tjerë në raport me subjektin afarist.

- Anëtarët e Odës ekonomike, subjektet afariste janë plotësisht të vetëdijshme dhe përgjegjëse për rëndësinë e përshtatjes ndaj dhe respektimit të normativës ligjore pozitive të vendit, por edhe akteve tjera nënligjore, marrëveshjeve kolektive dhe akteve tjera të cilat burojnë nga kushtetuta dhe ligjet, në veçanti ato lidhur me veprimtarinë afariste.
- Angazhimi dhe përkushtimi i kompanisë për të siguruar integritet fillon me respektimin e rregullave dhe ligjeve të të bërit biznes në sistemin e caktuar afarist. Për më tepër, është me rëndësi që të kuptohen dhe respektohen në tërësi edhe aktet dhe politikat organizative dhe të funksionimit të vetë kompanisë, si dhe të roleve dhe detyrave specifike të së cilit pjesëmarrës në procesin e punës së vetë kompanisë.
- Në qoftë se ekzistojnë dilema të caktuara nëse ndonjë veprim i planifikuar është i drejtë apo i lejuar nga ligji ose politikat e vetë kompanisë, duhet të konsultohen dokumentet dhe politikat relevante, si dhe kërkohen këshilla nga organet kompetente në strukturat e kompanisë, po ashtu ekspertiza e jashtme. Në fund, çdokush është përgjegjës për parandalimin e shkeljeve të ligjit dhe për ngritjen e zërit në rast se vërehen shkelje të mundshme.
- Është përgjegjësia e subjektit afarist, respektivisht organeve drejtuese të saj që të informojnë të punësuarit lidhur me kornizën e rregullave dhe ligjeve të zbatueshme specifike për veprimtarinë ose industrinë në të cilën vepron si dhe me mënyrën e zbatimit dhe përgjegjësinë juridike të çdo individit në raport me funksionin e tij në kompani.
- Kompania duhet të përkujdeset në mënyrë të vazhdueshme për përpilimin, përshtatjen dhe përditësimin e rregulloreve të saj, si dhe informimit dhe edukimit të personelit sipas standardeve më të fundit, pastaj për sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm, licencave dhe certifikatave të nevojshme me qëllim të funksionimit të papenguar të subjektit dhe në vijë me kërkesat ligjore.

NDAJ KLIENTIT / KONSUMATORIT DHE PALËT E TRETA / PARTNERËT E SUBJEKTIT AFARIST / BIZNESIT

BESUESHMËRIA

- Suksesi i çdo biznesi varet na besimi dhe kredibiliteti të cilën subjekti afarist ndërton në raport me klientët dhe konsumatorët, si dhe ndaj palëve të treta dhe partnerët e biznesit. Andaj, kompania duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të fituar dhe ruajtur besueshmërinë e tij duke iu përmbajtur zotimeve të veta, duke treguar ndershmëri dhe integritet gjatë punës dhe veprimtarisë së saj dhe duke arritur qëllimet e kompanisë vetëm përmes sjelljes së ndershme.
- Gjatë realizimit të aktiviteteve sipërmarrëse kompania si dhe anëtarët e saj çdo herë duhet të parashtrijë çështjen nëse veprimet të cilat ata i ndërmarrin, krahas tjerave do të ndikojnë në ngritjen e besueshmërisë për kompaninë dhe nëse kjo do të kontribuojë për krijimin e një ambienti më të mirë në punë dhe i cili do të garanton perspektivë më të mirë dhe sukses të mbarë subjektit afarist.

KUJDESI NDAJ KLIENTIT

- Kujdesi ndaj klientit është njëri ndër parimet dhe aktivitetet kryesore me të cilat duhet të merren subjektet afariste, në mënyrë që të përkujdesen që klientët të pranojnë produktet dhe shërbimet në mënyrën dhe kushtet më të mira dhe të kënaqshme të mundura, duke siguruar ndërveprim cilësor me biznesin dhe markën ose brendin e tij, si dhe mallrat dhe shërbimet që ai ofron.
- Kërkesat, propozimet si dhe ankesat e klientëve duhet të merren me seriozitetin më të madh, të njëjtat të shqyrtohen në mënyrë sa më të drejtë dhe në një afat të arsyeshëm, ndërsa në fund të ofrohen zgjidhjet e duhura për çështjen.
- Për trajtimin e mirëfilltë të mbështetjes apo kujdesit ndaj klientit, kompania duhet të mundësojë sistem dhe mënyra të përshtatshme të pranimit, shqyrtimit dhe përgjigjes ndaj kërkesave të klientit, qoftë para, gjatë ose pas dhënies së mallit apo shërbimit.
- Në kushtet dhe trendet bashkëkohore të funksionimit, në veçanti të një zhvillimi të hovshëm të teknologjisë informative, kompania përveç formave klasike të kujdesit ndaj klientit duhet të ofrojë poashtu edhe metoda tjera alternative dhe inovative të cilat janë më të kapshme dhe praktike për klientin (web faqe, aplikacion web ose mobil, asistent online, e-kiosk dhe të ngjashme).

SHITJA E PRODUKTEVE DHE OFRIMI I SHËRBIMEVE

SIPAS STANDARDEVE MË TË MIRA DHE NDALIMI I

KEQPËRDORIMIT DHE PRAKTIKAVE JO-FER TREGTARE

- Qasja proaktive dhe kualitative ndaj shitjes së produkteve dhe ofrimit të shërbimeve duhet të jetë segment prioritar dhe në të cilin kompania duhet të investojë vazhdimisht. Shitja dhe shërbimet duhet të ofrohen në cilësinë më të mirë të mundshme, në kohën më të arsyeshme dhe të shpejtë pasi që kjo është një aspekt shumë me rëndësi për klientin.
- Për më tepër shitja e produkteve dhe ofrimi i shërbimeve duhet të karakterizohen edhe me parimet e saktësisë dhe qartësisë së produkteve/shërbimeve të cilat ofrohen, prejardhjen e tyre, pastaj transparenca e plotë dhe qasja e lehtë e tyre përmes një raporti të kapshëm, miqësor dhe efikas ndaj klientit/konsumatorit.
- Keqpërdorimi në qarkullimin e mallrave dhe dhënien e shërbimeve, tregtia e paligjshme si dhe falsifikimi i produkteve janë probleme serioze me pasoja negative për subjektet afariste, pronarët e markave dhe brendeve tregtare, distributorët, shitësit me pakicë dhe konsumatorët, në fund edhe autoritetet ndërkombëtare dhe nacionale, prandaj si të tilla duhet të jenë rreptësisht të ndaluara dhe mos gjejnë aplikimin në punën e subjekteve afariste – anëtarë të Odës ekonomike.
- Anëtarët e Odës ekonomike duhet të jenë të përkushtuar në parandalimin dhe luftën me tregtinë e paligjshme, edhe atë duke zhvilluar dhe ndjekur mekanizma të përshtatshme për zbatimin e qasjeve efektive për luftimin e tregtisë së paligjshme.
- Praktikrat e jo-fer e të padrejta tregtare, të cilës do formë qofshin ato, si dhe pavarësisht fazën në të cilin ndodhin gjatë shkëmbimit tregtar, janë veprime në kundërshtim dhe të cilat e dëmtojnë rëndë mirëbesimin dhe tregtinë e drejtë, rrjedhimisht edhe imazhin dhe kredibilitetin e subjektit afarist.

TRANSPARENCA, NDALIMI I KONKURENCËS JO LOJALE DHE PRAKTIKAVE TJERA NEGATIVE NË BIZNES

- Subjektet afariste duhet të jenë çdo herë të përkushtuar për të pasur një konkurrencë lojale, etike, dhe të ndershme.
- Kompania duhet të punojë dhe tregtojë produkte dhe shërbime bazuar në meritat e tyre, me një cilësi dhe funksionalitet të lartë si dhe çmime të drejta dhe konkurruese.
- Subjektet afariste duhet të angazhohen për të marrë vendime të pavarura lidhur me produktet dhe shërbimet, apo edhe çmimet, prezantimin dhe marketingun rreth tyre dhe nuk do të veprojnë në mënyrë të papërshtatshme, të bashkëpunojnë ose të koordinojnë aktivitetet e tyre me konkurrentët në treg, në veçanti ato jashtë Odës ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore.
- Anëtarët e Odës ekonomike duhet të angazhohen në procese të koordinimit dhe bashkëpunimit, pjesëmarrjes së përbashkët në treg, solidarizimit dhe mbrojtjen e interesit të ndërsjellë.
- Gjatë kryerjes së veprimtarisë është e ndaluar mito dhe korrupsioni ose pagesat dhe dhuratat e paligjshme lidhur me tregtimin e mallrave ose shërbimeve, ose bojkotimi ndaj klientëve ose partnerëve të caktuar.
- Në këtë drejtim kompanitë duhet të përshtaten dhe respektojnë rregullat dhe parimet universale që kanë të bëjnë me marrjen apo dhënien e mitos dhe korrupsionin, si dhe parimet etike dhe profesionale në të gjitha vendet ku ato veprojnë.
- Duhet të përkrahen dhe promovohen praktikat pozitive, fer dhe transparente gjatë ushtrimit të veprimtarive biznesore, përfshirë informimin dhe komunikimin e rregullt me klientët apo konsumatorët, publikimin e dokumenteve dhe raporteve, si dhe mundësitë të qasjes dhe pjesëmarrjes më të gjerë në procesin e vendimmarrjes dhe krijimit të politikave zhvillimore të biznesit.

- Tregtia fer ose e drejtë nënkupton që subjekti afarist realizon veprimtarinë e saj bazuar në solidaritet, besueshmëri dhe respekt të ndërsjellë në raport me partnerët e saj tregtarë, në veçanti anëtarët e Odës ekonomike. Në këtë mënyrë, palët e përfshira në një marrëdhënie tregtare kërkojnë të rrisin vëllimin e tregtisë midis tyre dhe vlerën dhe larminë e ofertës së tyre të produkteve, rrjedhimisht edhe të ardhurat e tyre.
- Subjektet afariste – anëtarë të Odës ekonomike bashkëpunojnë ngushtë me njëra-tjetrën, si dhe me Odën ekonomike të Maqedonisë së Veriut me qëllim parandalimin dhe shmangien e konkurrencës jo-lojale dhe të pandershme.
- Informimi dhe komunikimi i subjekteve afariste me klientët apo konsumatorët si dhe palët e treta përmes kampanjave të ndryshme të marketingut është bërë pjesë integrale e veprimit afarist, ashtu si edhe tërë sistemit shoqëror dhe ekonomik. Konsumatorët mbështeten në informacionet e pranuar përmes marketingut në mënyrë që të marrin vendimet e tyre gjatë blerjes së mallrave ose shërbimet e tyre.
- Marketingu kontribuon në qarkullimin e produkteve, shërbimeve dhe ideve nga prodhuesit deri te konsumatori përfundimtar, si dhe është segment i rëndësishëm i cili vendos dhe mirëmban marrëdhëniet e biznesit me klientët, partnerët dhe aktorët e tjerë të rëndësishëm në kompani.
- Kështu, krahas tjerave është e një rëndësie të veçantë që subjektet afariste – anëtarë të Odës ekonomike të angazhohen në krijimin e strategjive dhe aktiviteteve të marketingut në mënyrë që të jenë sa më afër dhe në kontakt të drejtpërdrejtë me klientët e tyre.

PËRGJEGJËSIA SHOQËRORE E KOMPANIVE

POLITIKAT DHE AKTIVITETET PËR MBËSHTETJE TË SHOQËRISË DHE AMBIENTIT KU VEPRON KOMPANIA

- Përgjegjësia shoqërore e kompanive paraqet një koncept sipas të cilit subjektet afariste, përveç veprimtarisë së tyre të rregullt ose në kuadër të saj trajtojnë dhe integrojnë probleme të natyrave të ndryshme sociale.
- Çështjet kryesore të cilat adresohen me Përgjegjësinë shoqërore të kompanive kanë të bëjnë me problemet sociale, ambientin jetësor, efikasitetin energjetik, marrëdhëniet kompanive me komunitetin të cilit i takojnë, barazia sociale, barazia gjinore, qeverisja e mirë, e tjera.
- Përmes Përgjegjësisë shoqërore të cilën e demonstrojnë kompanitë ato japin kontributin e tyre proaktiv dhe vullnetar, me qëllim përmirësimin e kushteve sociale, ekonomike dhe mjedisore.
- Subjektet afariste të cilat ndërmarrin aktivitete në aspektin e përgjegjësisë sociale si dhe përmes saj, përveç tjerave në mënyrë indirekte përmes kësaj veprimtarie përmirësojnë besueshmërinë dhe imazhin e tyre në shoqërinë ku veprojnë, rrisin aftësitë konkurruese dhe përmirësimin e pozitës së tyre në treg, e tjera.

TË DREJTAT THEMELORE DHE RAPORTET NDAJ EKIPIT, PUNËTORËVE DHE AKSIONARËVE

- Subjektet afariste - anëtarë të Odës ekonomike duhet të tregojnë kujdes të veçantë dhe të zbatojnë denjësisht parimet dhe liritë e të drejtat themelore të njeriut si dhe standardet e punës të cilat burojnë na traktatet ndërkombëtare, në veçanti në raport me të punësuarit. Ato në këtë drejtim duhet të vendosin dhe ndjekin rregullore të veçanta të cilat garantojnë trajtim fer dhe të drejtë, si dhe parandalimin e çdo forme të diskriminimit, keqpërdorimit ose të abuzimit gjatë punës.
- Në të gjitha proceset e punës, në veçanti menaxhimit me burimet njerëzore, duke filluar që nga punësimi duhet të parandalohet dhe eliminohet në çdo nivel dhe situatë, çdo lloj diskriminim në bazë të moshës, gjinisë, racës, fesë, gjuhës, origjinës etnike, preferencës seksuale, besimit, statusit martesor, shoqëror ose ekonomik, e tjera.
- Orët dhe kushtet e punës, si dhe paga dhe benefitet tjera të caktuara për punëtorët duhet të jenë në përputhje me kushtet e përcaktuara nga ligjet nacionale, marrëveshjet kolektive dhe individuale, duke eliminuar çdo formë të diskriminimit dhe keqpërdorimit.
- Të gjithë meritojnë të punojnë në një mjedis ku trajtohen me dinjitet dhe respekt. Kompania duhet të jetë në kontinuitet e angazhuar për krijimin e një ambienti të rehatshëm dhe pozitiv për të punësuarit, në mënyrë që ata të jenë të kënaqur dhe ofrojnë potencialin e tyre të plotë e që nga ana tjetër, kontribuon drejtpërdrejt në suksesin e biznesit.
- Çdo punonjës i cili ndihet i ngacmuar ose diskriminuar duhet të ketë qasje në mbrojtje dhe të raportojë incidentet dhe shkeljet eventuale organet kompetente ose në zyrën e burimeve njerëzore të kompanisë.
- Për realizimin e të drejtave të tyre se mbrojtjen e interesit të të punësuarve ata mund të organizohen në shoqata të punëtorëve ose sindikata të cilat do të organizojnë dhe përmirësojnë pozitën e punëtorëve në kuadër të kompanisë, si dhe të përfaqësojnë interesat e tyre brenda dhe jashtë subjektit afarist në të cilin veprojnë.
- Subjektet afariste duhet të vendosin dhe praktikojnë sisteme adekuate dhe rregullore për mbrojtjen e shëndetit dhe garantimin e sigurisë në punë për çdo pozicion pune. Ajo duhet vazhdimisht të punojë në mënyrë që të ju sigurojë të punësuarve të saj kushte dhe mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm të punës në pajtim me ligjet dhe rregulloret për sigurinë dhe shëndetit në fuqi.
- Kompania duhet të synojë dhe në vazhdimësi të veprojë në drejtim të ngritjes së kapaciteteve dhe aftësitë e punonjësve të saj ose anëtarëve, siç janë aftësitë e menaxhimit, prodhimit ose shitjes, përmes gjetjes dhe ofrimit të shërbimeve adekuate të trajnimit.

- Situata me Pandeminë globale (COVID-19) ka shkaktuar shqetësimë të mëdha dhe në përmasa botërore në shoqëri, rrjedhimisht edhe në ekonomi, si dhe çështjet tregtare dhe punësimin në shumicën e veprimtarive afariste dhe pothuajse çdo industri dhe çdo vend.
- Kriza të ngjashme mund të ndodhin në vazhdimësi, andaj, në këto kushte është e një rëndësie të veçantë që subjektet afariste të mbledhin forcat dhe gjejnë mënyrat për konsolidimin e tyre dhe përshtatje me situata të krizave si këto.
- Menaxhimi dhe funksionimi gjatë kësaj krize kërkon vigjilencë dhe kujdes të madh nga ana e subjekteve afariste në mënyrë që të kenë në konsideratë dhe respektojnë parimet themelore të të bërit biznes, në veçanti të respektimit të nevojave dhe të drejtave të njeriut, në çdo cilësi që mund të kenë këto në raport me subjektin afarist (klientë, partnerë apo palë tjera), si dhe të drejtave themelore shëndetësore dhe humanitare, paralelisht me vazhdimësinë e veprimtarisë biznesore dhe iniciativat tjera në komunitetet.
- Në kushte krize apo pandemi, në veçanti siç është pandemia aktuale Covid-19, është e një rëndësie të veçantë të aplikohen dhe respektohen masat globale dhe nacionale të parandalimit dhe mbrojtjes nga rreziku i cili kanoset (maska dhe doreza për mbrojtje, mjete dezinfektuese, masa për distancë fizike si dhe mekanizma tjerë). Po ashtu, duhet të tregohet një kujdes i veçantë për nevojat mjekësore të stafit të kompanisë dhe menaxhimit adekuat të resurseve njerëzore.
- Në situata krize dhe pandemie, subjekti afarist duhet të udhëhiqet dhe respektojë parimet dhe rregullat e vendosura në nivel nacional dhe global, mirëpo për qëllimet e veta, si dhe mbarëvajtjen e procesit të punës mundet të përpilojë strategji dhe protokolle të veta për funksionim, krahas specifikave, nevojave dhe mundësive që ka.
- Protokollat për punë në situata krize dhe pandemie duhet të përfshijnë informacione, të dhëna si dhe instruksione lidhur me qëllimin që dokumenti ka, parandalimin dhe masat mbrojtëse gjatë punës, pastaj rregullimin e çështjeve të prezencës por edhe të mungesës në punë, mënyrën e shfrytëzimit të hapësirave të punës, puna në distancë ose na shtëpia, organizimit të transportit, mënyrën e reagimit dhe të raportimit në raste krize apo fatkeqësie, e tjera.
- Menaxhimi, pastaj edhe dalja e suksesshme nga kriza kërkon ndërmarrjen e një sërë masash dhe aktiviteteve që kanë të bëjnë me mënyrën e organizimit të punës në mesin apo rrjetin e subjektit afarist, por edhe jashtë atij, edhe atë:

- ndarjen në kohë të informacioneve të nevojshme dhe kritike, si dhe në formën e duhur, duke mundësuar anëtarët e subjektit afarist dhe partnerët të planifikojnë dhe veprojnë në mënyrë sa më efektive dhe efikase.
- subjektet afariste në raport të brendshëm me anëtarët e subjektit afarist dhe të punësuarit, por edhe në raport me partnerët e biznesit, në veçanti anëtarët e Odës ekonomike angazhohen për ofrimin e informacioneve si dhe ndihmën e duhur për njëri-tjetrin në mënyrë transparente dhe të besueshme lidhur me kërkesat dhe ofertat e pritura, po ashtu edhe për vonesat dhe ndryshimet eventuale të cilat mund të ndodhin në zinxhirin e prodhimit apo të shërbimeve të subjektit afarist, e që mund të ndikojë në palët e treta dhe partnerët e biznesit.

- Pavarësisht nga nevoja për bashkëpunim të gjerë solidaritet të ndërsjellë mes anëtarëve të Odës ekonomike dhe partnerëve të tyre në veprimtaritë ekonomike në situata krizash dhe pandemie, të gjithë duhet të jenë vigjilent dhe plotësisht të përkushtuar ndaj respektimit të kornizës juridike dhe ligjet në fuqi, në veçanti ato që kanë të bëjnë me garantimin e konkurrencës lojale në veprimtarinë afariste.
- Në kuadër të veprimeve për koordinim dhe shkëmbimin e informacioneve mes subjekteve afariste informacionet e ndjeshme dhe të besueshme tregtare, përfshirë kërkesat apo ofertat, gjendja me kapacitetet prodhuese ose shërbyese në kohë krize apo pandemie, duhet të kufizohen në subjektet partnere të zinxhirit të njëjtë të vlerave dhe veprimit, ndërsa mos të shpërndahen me konkurrentët.
- Ndarja e informacioneve të tilla me konkurrentet në treg në situata të domosdoshme, duhet të realizohet në bazë të rregullave të veçanta, në pajtim me rregullativën dhe autoritetet ligjore për sigurimin e konkurrencës lojale dhe të drejtë, si dhe në bazë të akteve të Odës ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE TË KODEKSIT

- Kodeksi i praktikave të mira afariste i Odës ekonomike duhet të pranohet dhe të zbatohet nga ana e subjekteve afariste – anëtarë të Odës ekonomike në mënyrë të hapur dhe transparente. Me këtë rast Oda ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore inkurajon anëtarët e saj për të diskutuar mbi Kodeksin e praktikave të mira afariste në baza të vazhdueshme lidhur me gjitha çështjet dhe dilemat që mund të ekzistojnë në drejtim të përmirësimit dhe praktikimit sa më të lehtë e të suksesshëm të tij.
- Oda ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore po ashtu inkurajon anëtarët e saj që përveç pranimin dhe zbatimit të këtij Kodeksi dhe parimeve të përgjithshme të tij, të angazhohen edhe për përgatitjen e Kodekseve të veçanta të tyre, varësisht na veprimtaria, specifikat dhe nevojat të cilat i kanë ata.
- Në qoftë se ndonjë parim, rekomandim ose dispozitë e këtij Kodeksi shkelin ose bien ndesh me dispozitat ligjore ose rregulloret në fuqi atëherë të njëjtat mund të shfuqizohen, ose dispozitat, ligjet ose rregulloret në fuqi do të mbizotërojnë. Sidoqoftë, të gjitha palët e përfshira duhet të orientohen dhe përipiqen të respektojnë frymën e përgjithshme të dispozitave të këtij Kodeksi.
- Sjelljet dhe veprimet të cilat nuk janë në përputhje me këtë Kodeks duhet të evitohen dhe përmirësohen menjëherë.
- Lidhur me shkeljet e këtij Kodeksi kompania mund të parasheh zbatimin e masave disiplinore ndaj shkelësve, varësisht edhe nga ligjet dhe rregulloret administrative në fuqi.
- Subjekti afarist, bartës i këtij Kodeksi në të ardhmen duhet të ofrojë garanci të mjaftueshme juridike dhe konfidenciale në rastet kur subjekte të caktuara mund të shprehin shqetësime të mundshme shkeljet e parimeve të këtij Kodeksi. Të gjitha informacionet dhe raportimet e bëra lidhur me anashkalimin dhe me shkeljet eventuale të tij duhet të hetohen dhe zgjidhen menjëherë sipas procedurave të parapara.



Rr. Dimitrie Çupovski 13,
1000 Shkup, RMV
Tel. +389 (0)2 3239 252
oemvp.org